

UDHËZIM
Nr. 8, datë 19.12.2019

**PËR KRITERET, RREGULLAT DHE DOKUMENTACIONIN PËR LËSHIMIN
E LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË
UDHËTARËVE¹**

Mbështetur në: nenin 102, pika 4 e Kushtetutës; ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; VKM nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar; VKM nr. 325, datë 19.3.2008, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuar për këta operatorë”, të ndryshuar;

duke pasur parasysh: liria për të ofruar shërbime përbën një parim themelor të politikës së transportit dhe kërkon që subjekteve t’u garantohet qasje pa dallim në tregjet ndërkombëtare të transportit;

duke përshtatur: rregulloret, direktivat dhe vendimet e Bashkimit Evropian, të zbatueshme në transportin rrugor të udhëtarëve;

me qëllim: rregullimin, disiplinimin dhe monitorimin e veprimtarisë që ushtrohet ose që kërkohet të ushtrohet nga subjekte në fushën e transportit rrugor, si dhe integrimin e plotë të tyre në tregun Evropian të transportit rrugor, zhvillimin në mënyrë harmonike të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus, rritjen e sigurisë në transportin rrugor dhe mbrojtjen e ambientit, nevojën për të standardizuar dhe lehtësuar procedurat administrative, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë nxjerr këtë udhëzim.

KAPITULLI I
QËLLIMI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIME

1. Qëllimi

Ky udhëzim përcakton kriteret, rregullat dhe procedurat që kërkohen për trajtimin në përputhje me dispozitat ligjore, të aplikimeve sipas dokumentacionit provues të paraqitur nga subjekte të regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë, për lëshimin, pezullimin apo heqjen e licencave, autorizimeve dhe certifikatave në transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve, si dhe lëshimin e autorizimeve për subjektet e huaja të shteteve, palë në marrëveshje ose vend të tretë, me destinacion Shqipërinë apo transit nëpër territorin shqiptar.

2. Fusha e zbatimit

2.1 Ky udhëzim zbatohet për të gjithë subjektet e angazhuara ose që synojnë të angazhohen në veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve për të tretë ose me qira dhe për

¹ Ky udhëzim është përafshuar pjesërisht me:

- Rregulloren (KE) nr. 1071/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, “Mbi vendosjen e rregullave të përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për ushtrimin e profesionit të operatorit të transportit rrugor, e cila shfuqizon direktivën e Këshillit 96/26/KE” (OJ L 300, 14.11.2009, faqe 51-71), amenduar me rregulloren e Komisionit (BE) nr.613/2012, datë 9.7.2012 (OJ L 178, f. 6, datë 10.7.2012) dhe rregulloren e Këshillit (BE) nr. 517/2013, datë 13.5.2013 (OJ L 158, f. 1, datë 10.6.2013);

- Rregulloren (KE) nr. 1073/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta për hyrjen në tregun ndërkombëtar të shërbimeve me autobus” (OJ L300/2009, f. 72, datë 14.11.2009), duke amenduar rregulloren (KE) nr. 561/2006;

- Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 361/2014, datë 9 prill 2014, “Mbi vendosjen e rregullave të detajuara për aplikimin e rregullores (KE) nr. 1073/2009, në lidhje me dokumentet për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus, duke shfuqizuar rregulloren e Komisionit (KE) nr. 2121/98” (OJ L 107, f. 39, datë 10.4.2014).

llogari të vet, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, nga subjekte të themeluara/vendosura në Shqipëri, në një shtet të palës kontraktuese ose vend të tretë, duke përdorur mjete të cilat janë regjistruar, të përshtatshëm dhe të destinuar për të transportuar më shumë se nëntë persona, përfshirë drejtuesin e mjetit.

Licencimi dhe/ose autorizimi është i detyrueshëm për subjektet që ofrojnë:

- a) shërbime të rregullta;
- b) shërbime të rregullta të specializuara;
- c) shërbime të rastit.

2.2 Certifikimi është i detyrueshëm për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në transportin ndërkombëtar për llogari të vet.

3. Përkufizime

Të gjithë termat e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, të ndryshuar; në VKM nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 446, datë 10.5.2018, “Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifrat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë udhëzim, ndërsa termat që përdoren në tekstin e këtij udhëzimi, kanë kuptim si më poshtë:

3.1 **Autoritet kompetent** nënkupton organin, i cili ka autoritetin ose i është deleguar autoriteti për lëshimin, pezullimin dhe heqjen e licencave, autorizimeve dhe certifikatave.

3.2 **Autorizim** është një dokument që rrjedh nga marrëveshjet dypalëshe në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, nga rregullorja (KE) nr. 1073/2009 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe rregullorja (BE) e Komisionit nr. 361/2014 në zbatim të saj, që i njeh të drejtën subjektit, vendas apo të huaj, për të kryer një numër të pakufizuar udhëtimesh dhe për një periudhë të caktuar kohe, në shërbimet e rregullta dhe shërbimet e rregullta të specializuara.

3.3 **Kritere të licencimit/ autorizimit** janë pjesë e kushteve, në përputhje me rregulloret e BE-së, nga përmbushja e të cilave bazohet dhënia e licencës/ autorizimit.

3.4 **Marrëveshja INTERBUS** është marrëveshja për transportin ndërkombëtar rrugor të rastit të udhëtarëve me autobus, në të cilën Shqipëria ka aderuar me ligjin nr. 9305, datë 4.11.2004, si edhe në linjë të rregullt dhe të rregullt të specializuar, sipas Protokollit përkatës të Marrëveshjes INTERBUS.

3.5 **Mjet motorik M2** është mjeti motorik i destinuar për transportin e njerëzve që përmban më shumë se 8 ndenjëse, përveç vendit të drejtuesit të mjetit dhe që ka një masë maksimale që nuk kalon 5 tonë.

3.6 **Mjet motorik M3** është mjeti motorik i destinuar për transportin e njerëzve që përmban më shumë se 8 ndenjëse, përveç vendit të drejtuesit të mjetit dhe që ka një masë maksimale që i kalon 5 tonë.

3.7 **Pala kontraktuese** nënkupton atë shtet që ka dhënë dakordësinë/ pëlqimin për kryerjen e veprimtarisë së transportit, sipas marrëveshjes dypalëshe për aq kohë sa kjo marrëveshje është në fuqi.

3.8 **QKB** është Qendra Kombëtare e Biznesit.

3.9 **Regjistri Elektronik Kombëtar (REK)** është regjistri ku janë të regjistruar të dhënat për subjektet e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve për të tretë ose me qira dhe për llogari të vet, të vendosura në Shqipëri.

3.10 **Subjekt** nënkupton çdo person juridik ose fizik tregtar, si edhe çdo term tjetër të përdorur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi si operatorë transporti, ndërmarrje transporti, transportues etj., që ushtron veprimtarinë në transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve me autobus, i regjistruar paraprakisht në regjistrin tregtar.

3.11 **Shërbimet e rregullta** nënkuptojnë shërbime të cilat sigurojnë transportin e udhëtarëve në intervale të caktuara përgjatë itinerareve të përcaktuara, ku udhëtarët hipin dhe zbresin, në vendqëndrime të paracaktuara. Këto shërbime kryhen në linja të rregullta, në përputhje me

marrëveshjet dypalëshe të transportit rrugor ku Republika e Shqipërisë është palë.

3.12 **Shërbimet e rregullta të specializuara** nënkuptojnë shërbimet e rregullta, nga kushdo që janë organizuar, të cilat sigurojnë transportin e kategorive të caktuara të udhëtarëve, duke përjashtuar udhëtarët e tjerë.

Shërbimet e rregullta të specializuara përfshijnë:

- a) transportin shtëpi-punë dhe anasjelltas të punonjësve;
- b) transportin shtëpi-institucion shkollor dhe anasjelltas të nxënësve dhe studentëve.

3.13 **Shërbime të rastit** nënkuptojnë shërbimet, që nuk i përgjigjen përkufizimit të shërbimeve të rregullta dhe të rregullta të specializuara, dhe karakteristika kryesore e të cilave është transporti i grupeve të udhëtarëve të formuar me iniciativën e personave të interesuar ose të vetë transportuesit. Në shërbimet e rastit nuk lejohen të lihen ose të merren udhëtarë gjatë udhëtimit, me përjashtim të rasteve kur kjo autorizohet nga autoriteti kompetent për territorin ku kryhet transporti (shërbimet e paliberalizuara).

3.14 **Transport ndërkombëtar** nënkupton udhëtimin e ndërmarrë nga një mjet:

- a) kur pika e nisjes dhe pika e mbërritjes e të cilit janë në dy Palë të ndryshme Kontraktuese, me ose pa transit nëpërmjet një ose më shumë Palëve Kontraktuese ose vendeve të treta;
- b) kur pika e nisjes dhe pika e mbërritjes janë në të njëjtën Palë Kontraktuese, ndërsa marrja ose zbritja e udhëtarëve është në një Palë tjetër Kontraktuese ose në një vend të tretë;
- c) nga një Palë Kontraktuese drejt një vendi të tretë ose anasjelltas, me ose pa transit nëpërmjet një ose më shumë Palëve Kontraktuese ose vendeve të treta; ose
- d) ndërmjet vendeve të treta, me transit nëpër territorin e një ose më shumë Palëve Kontraktuese.

3.15 **Transit** nënkupton pjesën e udhëtimit përmes territorit shqiptar, ose të një shteti tjetër, në të cilin nuk hipin apo zbresin udhëtarë.

3.16 **Transport për llogari të vet** nënkupton operimet e transportit të kryera për qëllime jo tregtare dhe pa qëllim fitimi, nga një subjekt, me kusht që:

- a) transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse për subjektin;
- b) autobusët e përdorur të jenë pronë e subjektit, apo të jenë blerë me këste ose të jenë objekt i një kontrate qiramarrje afatgjatë dhe të drejtohen nga një punonjës i subjektit.

3.17 **Shkelje serioze** e legjislacionit në transportin ndërkombëtar nënkupton një shkelje që mund të çojë në humbjen e reputacionit të mirë në përputhje me nenin 6 (1), (2) të rregullores (KE) nr. 1071/2009, dhe/ ose në tërheqje të përkohshme apo të përhershme të licencës për transport ndërkombëtar të udhëtarëve.

KAPITULLI II

PARIME TË PËRGJITHSHME DHE KOMPETENCAT PËR LËSHIMIN E LICENCËS, AUTORIZIMIT, CERTIFIKATËS

4. Parime të përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë në transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve.

4.1 Ushtrimi i veprimtarisë në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, sikundër përcaktohet në ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, të ndryshuar, bazohet në parimet:

- a) e proporcionalitetit, deburokratizimit dhe uljes së barrierave administrative;
- b) e interesave publikë që ato garantojnë dhe mund të jenë: aftësi profesionale apo fizike, përvojë apo njohuri, mënyrë organizimi, zotërimi i një teknike apo teknologjie të caktuar, gjendje apo garanci pasurore, gjendje juridike apo norma të sjelljes etj.

4.2 Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve rregullohet nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe në fushën e transportit rrugor, marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë ka aderuar dhe *acquis* të BE-së.

4.3 Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve në linjë të rregullt/ të rregullt të specializuar me një

shtet, me të cilin Republika e Shqipërisë është palë në një marrëveshje transporti rrugor, shoqërohet me autorizimin e lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit, nëpër territorin e të cilit kalon transit ose përfundon linja.

4.4 Shërbimet e rastit në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, kryhen me anën e librit të udhëtimit, në bazë të marrëveshjes INTERBUS (për shtetet palë në këtë marrëveshje). Për shtetet e tjera ky shërbim kryhet në përputhje me marrëveshjet dypalëshe.

4.5 Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve për llogari të vet kryhet nëpërmjet certifikatës për llogari të vet, referuar modelit dhe kushteve të përcaktuara në rregulloren (BE) të Komisionit nr. 361/2014.

4.6 Nuk lejohet marrja dhe zbritja e udhëtarëve nga një transportues i huaj brenda territorit shqiptar, (kabotazhi), me përjashtim të rasteve të veçanta dhe me autorizim të ministrit.

5. Autoriteti kompetent për lëshimin e licencës, autorizimit, certifikatës në transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve

<i>Lloji i veprimtarisë</i>	<i>Dokumenti</i>	<i>Autoriteti kompetent</i>	<i>Baza ligjore</i>
Transport ndërkombëtar rrugor udhëtarësh	Licencë	QKB	Ligji nr. 10081, datë 23.2.2009, i ndryshuar; VKM nr. 538, datë 26.5.2009, e ndryshuar
Shërbimet në linjë të rregullt/ të rregullt të specializuar	Autorizim	Ministria (MIE)	Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998, i ndryshuar
Shërbimet e rastit	Libër udhëtimit	ANALTIR	Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998, i ndryshuar
Transport për llogari të vet	Certifikatë	DPSHTRR	Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998, i ndryshuar

5.1 **Autoriteti kompetent** është përgjegjës për të siguruar zbatimin korrekt të këtij udhëzimi dhe është i autorizuar për të:

- kontrolluar aplikimin e bërë nga subjekti;
- kontrolluar deklarin e subjektit dhe drejtuesit të veprimtarisë;
- kryer kontrollat e kërkuara për verifikimin nëse një subjekt kënaq kërkesat sipas pikës 6, të këtij udhëzimi dhe plotëson kushtet e përcaktuara në përputhje me rregullat për pranimin në profesionin e operatorit të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve;
- lëshuar dokumente si: licencë, autorizim, certifikatë, libër udhëtimit për subjekte të angazhuara në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të pezullojë ose tërheqë/anulojë këto dokumente.

KAPITULLI III KRITERET BAZË TË LICENCIMIT

6. Kriteret e licencimit

6.1 Kërkesat bazë

Për të ushtruar veprimtarinë e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve, e cila është subjekt licencimi, subjektet paraqesin kërkesë pranë autoritetit kompetent, duke provuar se plotësojnë kriteret e posaçme sipas këtij udhëzimi, kreut II.1, të VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar, të reflektuara edhe në aneksin 1, të VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar, që janë:

- një vendosje efektive dhe të qëndrueshme në Shqipëri,
- reputacioni i mirë,
- qëndrueshmëria financiare,
- kompetenca profesionale.

A. Plotësimi i kriterit për një vendosje efektive dhe të qëndrueshme në Shqipëri

Për të kënaqur plotësimin e këtij kriteri, subjekti duhet:

A.1 Të ketë vendndodhjen në Shqipëri me zyrën/ ambientin, në të cilin ai mban dokumentet e veprimtarisë së tij, në veçanti dokumentet e tij financiare dhe të menaxhimit të personelit, dokumente që përmbajnë të dhëna lidhur me kohën e drejtimit dhe pushimit të drejtuesit/ drejtuesve të mjetit/ mjeteve, si dhe çdo dokument tjetër për të cilin autoritetet e ngarkuara me ligj për kontrollin e dokumentacionit duhet të kenë akses, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me kushtet e përcaktuara në këtë udhëzim dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

A.2 Për një shërbim të caktuar, për të cilin aplikon, të ketë në dispozicion të tij një ose më shumë mjete, të cilët janë regjistruar ose janë vënë në qarkullim në përputhje me legjislacionin shqiptar.

A.3 Të drejtojë efektivisht dhe vazhdimisht me mjete administrative dhe me pajisje të përshtatshme teknike operacionet e nevojshme lidhur me mjetet.

B. Plotësimi i kriterit në lidhje me reputacionin e mirë

B.1 Subjekti konsiderohet se plotëson kriterin e reputacionit të mirë kur plotëson kërkesat e kapitullit II, pikës 3, të VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar.

B.2 Çdo subjekt, që kërkon të ushtrojë veprimtari në transport ndërkombëtar të udhëtarëve, duhet të deklarojë se plotëson kriterin e reputacionit të mirë nëpërmjet plotësimit të formularit të vetëdeklarimit nga përfaqësuesi ligjor dhe drejtuesi i veprimtarisë (lidhjet 7 dhe 7.1).

B.3 Referuar shkronjës B.4, më poshtë, autoriteti kompetent përcakton kushtet për t'u plotësuar nga subjekti dhe drejtuesi i veprimtarisë, me qëllim kënaqjen e kërkesave të reputacionit të mirë.

Çdo referencë në këtë shkronjë për dënimet, gjobat ose shkeljet, do të përfshijë dënimet, gjobat ose shkeljet e vetë subjektit, të drejtuesit të veprimtarisë së transportit dhe çdo personi tjetër të përshtatshëm të përcaktuar nga autoriteti kompetent.

B.4.Referencat në paragrafin e mësipërm, përfshijnë të paktën kushtet si në vijim:

a) nuk ka pasur ngjarje detyruese për dyshim të reputacionit të mirë të tillë si, dënimet ose gjobat për çdo shkelje serioze të legjislacionit dhe rregullave në fuqi në Shqipëri, përkatësisht:

i. ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, të ndryshuar,

ii. ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, të ndryshuar,

iii. ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar,

iv. ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, "Për falimentimin",

v. VKM nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar,

vi. kushtet e punësimit dhe të pagesës në profesion,

vii. përgjegjësinë profesionale,

viii. trafikimin e qenieve njerëzore ose drogave.

b) subjekti ose drejtuesi i veprimtarisë nuk ka qenë i dënuar në të kaluarën për një veprim të rëndë kriminal ose të ketë pësuar një ndëshkim/ gjobitje për një shkelje serioze të rregullave në veçanti lidhur me:

i. kohën e drejtimit dhe periudhat e pushimit për drejtuesit e mjeteve, kohën e punës, instalimin dhe përdorimin e pajisjeve të regjistrimit,

ii. peshat dhe përmasat maksimale të mjeteve në transportin ndërkombëtar,

iii. kualifikimin fillestar dhe trajnimin periodik të drejtuesve të mjeteve,

iv. kontrollet e mjeteve, përfshirë inspektimin teknik,

v. pranimin në veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve,

vi. instalimin dhe përdorimin e pajisjeve të kufizuesve të shpejtësisë në disa prej kategorive të mjeteve,

vii. lejet e drejtimit,

viii. transportin e kafshëve.

B.5 Për qëllime të shkronjës B.4, nëse subjekti ose drejtuesi i veprimtarisë ka qenë dënuar për

një shkelje serioze kriminale ose ka pësuar një ndëshkim për një nga shkeljet serioze (lidhja 8), autoriteti kompetent do të kryejë në mënyrë dhe në kohë të përshtatshme një procedurë të plotë administrative, e cila do të përfshijë një kontroll në ambientet e subjekteve përkatëse.

Procedura do të përcaktojë nëse në rrethana specifike të caktuara, humbja e reputacionit të mirë përbën një vendim të drejtë dhe proporcional për çdo rast të veçantë. Çdo gjetje e tillë do të duhet të arsyetohet dhe justifikohet.

Nëse autoriteti kompetent konstaton se humbja e reputacionit të mirë do të përbente një vendim të padrejtë, mund të vendosë që reputacioni i mirë të mos ndikohet. Në këtë rast, arsyet regjistrohen në regjistrin elektronik kombëtar.

Nëse autoriteti kompetent konstaton se humbja e reputacionit të mirë do të përbente një vendim të drejtë, dënimi ose gjoha do të çojë në humbjen e reputacionit të mirë.

C. Plotësimi i kriterit për qëndrueshmërinë financiare

Subjekti kënaq kriterin e qëndrueshmërisë financiare kur plotëson dispozitat e kapitullit II, pikës 5, të VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar, konkretisht shkronja “a”, e pikës 5.2: “a) Jo më pak se 9 000 euro, për autobusin e parë dhe 5 000 euro për çdo autobus shtesë, të autorizuar për t’u përdorur në transportin ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve;”.

D. Plotësimi i kriterit në lidhje me kompetencën profesionale

D.1. Subjekti konsiderohet se plotëson kriterin në lidhje me kompetencën profesionale kur është i pajisur me certifikatën përkatëse të kompetencës profesionale (CKP) për transport ndërkombëtar të udhëtarëve lëshuar sipas udhëzimit nr. 1, datë 28.1.2009, “Për pajisjen me certifikatën e kompetencës profesionale të drejtuesit të veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor”, të ndryshuar.

D.2 Nëse subjekti nuk plotëson kërkesat në përputhje me kompetencën profesionale, do të caktojë një drejtues veprimtarie transporti sipas kërkesave të kapitullit II, pikës 2.2, të VKM nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar.

E. Gjendja e përshtatshme e mjeteve dhe qiramarrja

E.1 Subjekti konsiderohet se plotëson kërkesën për gjendjen e mirë të mjeteve, nëpërmjet plotësimit të standardeve të sigurisë rrugore, standardeve të zhurmave dhe të ndotjes së ambientit, si dhe kërkesat në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve.

E.2 Në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, pas pajisjes me certifikatën e kontrollit teknik të mjetit, subjekti paraqet mjetin/ mjetet për përfitimin e aktvlerësimit në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve në përputhje me aneksin 1, të udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

E.3 Kërkesat për qiramarrjen e mjeteve nga subjektet e tjera:

a) subjektet mund të marrin me qira mjete M2 ose M3 pa drejtues mjeti, kur qiradhënësi, kundrejt pagesës, vë në dispozicion të qiramarrësit, me kërkesën e këtij të fundit, vetë mjetin;

b) qiramarrësi është përgjegjës për operimin në kushte të sigurta të mjetit të marrë me qira. Ai kryen kontrollet e duhura para përdorimit dhe mban regjistrimet e nevojshme për përdorimin e mjetit, përfshirë mirëmbajtjen e tij;

c) qiramarrësi sigurohet që dokumentet të cilat duhet të mbahen në mjet, të jenë në përputhje me kërkesat sipas shërbimeve përkatëse (referuar dispozitave të përgjithshme për secilin shërbim);

d) pronarët e mjeteve mund t’u japin me qira subjekteve që operojnë në linjë të rregullt të udhëtarëve, përkohësisht dhe në raste të jashtëzakonshme, sipas këtij udhëzimi, një pjesë të mjeteve të tyre me miratim të autoriteteve kompetente;

e) një subjekt mund të marrë me qira një mjet nga një subjekt tjetër për një periudhë të përkohshme, në përputhje me afatet dhe mënyrat e përcaktuara si më poshtë:

i. subjekti mund të marrë me qira, me ose pa drejtues, një mjet transporti për rastin e mjeteve të prishur apo mjeteve që janë për riparim. Qiramarrja e mjetit mund të bëhet për aq kohë sa subjekti e sheh të arsyeshme, por jo më shumë se 6 muaj,

- ii. në raste emergjence ose piku/ fluksi, të paparashikuar, një subjekt merr me qira një mjet, me ose pa drejtues, për një periudhë deri sa zgjat piku/ fluksi, por jo më shumë se 3 muaj,
- iii. mjeti i marrë me qira duhet të jetë në përputhje me shkronjën E.1, të këtij udhëzimi.

6.2 Drejtuesi i veprimtarisë së transportit

6.2.1 Çdo subjekt duhet:

- të caktojë një drejtues veprimtarie në përputhje me dispozitat e kapitullit II, pikës 2, të VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar,
- të njoftojë autoritetin kompetent të lëshimit të licencës, autorizimit për ndryshime të mundshme në kontraktimin e drejtuesit të veprimtarisë dhe brenda 30 ditëve paraqitet në QKB për të kryer ndryshimet e nevojshme.

6.2.2 Personat që punojnë në organet e transportit ose të varësisë, në QKB, ose në organet e kontrollit në rrugë sipas nenit 12, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, të ndryshuar, që mbulojnë veprimtarinë e transportit rrugor dhe që janë të pajisur me certifikatën e kompetencës profesionale, nuk lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si drejtues veprimtarie në një subjekt. Shmangia nga ky rregull përbën shkelje të reputacionit të drejtuesit të veprimtarisë dhe shkak për heqjen e certifikatës së kompetencës profesionale.

KAPITULLI IV PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE/ AUTORIZIMEVE/ CERTIFIKATAVE

7. Dorëzimi, pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave

7.1 Subjektet që dëshirojnë të ushtrojnë veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve, për t'u pajisur me licencë paraqesin kërkesën (lidhja 5), të shoqëruar me dokumentet provuese për përmbushjen e kriterëve, sipas pikës 6.1, të cilat paraqiten pranë autoritetit kompetent sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara.

7.1.1 Aplikimi për t'u pajisur me licencë, pasi dorëzohet në QKB, bazuar në nenin 31, seksioni VI, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, të ndryshuar, shqyrtohet brenda afateve kohore të përcaktuara, nga autoriteti kompetent përkatës. Aktmiratimi (lidhja 9), për lëshimin e licencës mund të jepet vetëm në përgjigje të një aplikimi nëpërmjet QKB-së.

7.1.2 Kërkesat që kanë lidhje me aplikimet për pajisjen me autorizim për shërbimet e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve në linjë të rregullt, dorëzohen në zyrën e protokollit pranë autoritetit kompetent, nëpërmjet shërbimit me postë me lajmërim-marrje ose dërgimit me mjete elektronike, në përputhje me legjislacionin për nënshkrimin elektronik.

7.1.3. Kërkesat që kanë lidhje me aplikimet për pajisjen me certifikatën për transport ndërkombëtar të udhëtarëve për llogari të vet, dorëzohen në zyrën e protokollit pranë autoritetit kompetent, nëpërmjet shërbimit me postë me lajmërim-marrje ose dërgimit me mjete elektronike, në përputhje me legjislacionin për nënshkrimin elektronik.

7.2. Sektori/ zyra/ specialisti përgjegjës i autoritetit kompetent ka këto përgjegjësi dhe detyra:

a) në përputhje me rregullat e parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat" dhe rregulloret në zbatim të tij dhe sipas pikës 7.1, administron aplikimet për licencim, autorizim, certifikim;

b) regjistron në regjistra të posaçëm në formë shkresore dhe elektronike çdo aplikim të ndarë përkatësisht: licencim, autorizim, certifikim, aplikim për herë të parë, rinovim, kërkesa për zëvendësim, pezullim, lëshim dublikate etj.;

c) kur aplikimi nuk shoqërohet me dokumentacionin provues dhe shoqërues sipas këtij udhëzimi, sektori/ zyra/ specialisti përgjegjës brenda 5 ditë pune nga marrja në dorëzim, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, i komunikon me shkrim aplikuesit kërkesën për plotësim dokumentacioni. Komunikimi me shkrim pezullon afatet e shqyrtimit të kërkesës;

d) sektori/ zyra/ specialisti përgjegjës duhet të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien

e informacioneve të tjera, të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë procedurat për lëshimin e licencës, autorizimit, certifikatës. Dokumentet provuese (në origjinal ose të njehsuara me origjinalin), që janë paraqitur gjatë një aplikimi të mëparshëm dhe janë brenda afatit të vlefshmërisë nuk kërkohen të paraqiten për një aplikim të ngjashëm. Sektori/ zyra/ specialisti përgjegjës i licencimit i pranon dokumentet provues për trajtim edhe/ ose kopje;

e) materiali për shqyrtimin e kërkesave nga subjektet që aplikojnë për t'u pajisur me licencë, autorizim, certifikatë për llogari të vet përgatitet nga sektori/ zyra/ specialisti përgjegjës për licencimin, autorizimin, certifikimin, vetëm për ato subjekte, të cilët kanë plotësuar dokumentacionin në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Materiali duhet të jetë i plotë dhe të pasqyrojë me hollësi të gjithë elementet e nevojshëm sipas veprimtarive përkatëse;

f) në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për aplikimet nëpërmjet QKB-së, afati për shqyrtimin dhe marrjen e një aktmiratimi (kur aplikimi rezulton të jetë i plotë), ose refuzimi, (nëse rezulton të jetë me mangësi), është 10 ditë pune, sipas VKM-së nr. 1295, datë 29.12.2009, që ndryshon VKM nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar.

7.3 Autoriteti kompetent, shqyrton aplikimet përkatëse, mbështetur në ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, të ndryshuar, VKM nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar dhe në zbatim të pikës 5.1. të këtij udhëzimi, si vijon:

a) autoriteti kompetent për shqyrtimin e aplikimeve organizon procedurat për trajtimin e tyre mbështetur në pikën 5, të nenit 20, seksionin II, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 dhe në pikën II, nënpika 5, shkronja "a", dhe VKM nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar;

b) në rastet kur bëhet i pamundur shqyrtimi i aplikimit brenda afatit 10-ditor, aplikohet shtyrja e shqyrtimit të aplikimeve sipas procedurave të QKB-së, por jo më shumë se një herë dhe jo më shumë se 10 ditë pune. Në rast të kundërt aplikohet miratimi në heshtje;

c) bazuar në materialin e përgatitur nga sektori/ zyra/ specialisti përgjegjës, autoriteti kompetent shqyrton materialin e përgatitur, i cili kthehet në aktmiratimi, pasi miratohet nga eprori përkatës, që mbulon sektorin/ zyrën/ specialistin përgjegjës;

d) sigurohet që procedura për miratimin ose refuzimin dhe përcjelljen në QKB me rrugë elektronike të kryhet brenda afateve ligjore, sipas pikës 7.2, shkronja "F".

6.4 Sektori/ zyra/ specialisti përgjegjës mbas shqyrtimit të aplikimit vepron si më poshtë:

a) i përcjell QKB-së me rrugë elektronike, aktmiratimin ose refuzimin e aplikimeve, bazuar në gjetjet nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura;

b) përgatit formatin e certifikatave për llogari të vet sipas standardeve të miratuara, për subjektet që kanë plotësuar dokumentacionin në përputhje me këtë udhëzim.

7.5 Trajtimi i aplikimeve për t'u pajisur me autorizim në transport ndërkombëtar në linjë të rregullt dhe në linjë të rregullt të specializuar, si për subjektet me vendndodhje në territorin shqiptar, ashtu edhe subjektet e huaja, të palëve kontraktuese, kryhet nga sektori në varësi të drejtorisë që mbulon politikat e transportit rrugor në ministri.

7.5.1 Aplikimet për t'u pajisur me autorizim shqyrtohen nga specialisti/tët përgjegjës, konform marrëveshjes/eve në fuqi dhe veprohet në përputhje me pikën 7.2, shkronjat "a", "b", "c", "d" dhe "e" të këtij udhëzimi. Në përfundim të shqyrtimit të aplikimeve përgatitet aktkonstatimi (lidhja 10), i cili miratohet nga drejtori që mbulon politikat e transportit rrugor në ministri.

7.5.2 Sektori/ zyra/ specialisti përgjegjës përgatit formatet e autorizimeve, sipas modeleve të miratuara, shkresat përcjellëse që i drejtohen ministrive homologe, bazuar në marrëveshjet dypalëshe, si për aplikimet e paraqitura nga ana e subjekteve shqiptare drejtuar autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese, po ashtu edhe nga ana e subjekteve të huaja të palëve kontraktuese drejtuar autoritetit kompetent shqiptar, sipas kërkesave përkatëse. Aktkonstatimi, shoqëruar me formatet e autorizimeve, anekset përkatëse dhe shkresat përcjellëse i paraqiten zv/ministrin që mbulon çështjet e transportit, për nënshkrim dhe vazhdimin e procedurave.

Njoftimi mbi lëshimin e autorizimit/ve i përcillet ministrive homologe, shoqëruar me një kopje të autorizimit për subjektin shqiptar dhe autorizimin/et origjinale për subjektin e huaj. Në

rastet e refuzimit të kërkesës jepen arsytet mbi refuzimin.

7.5.3 Nga rregulli për paraqitjen e kërkesave zv/ministrit përjashtohen ato aplikime, miratimi i të cilave nuk sjell ndryshime në titullin e autorizimit, si:

- shtesa dhe/ ose zëvendësimi i mjeteve në një linjë të rregullt,
- modifikimi i tabelës së tarifave.

7.6 Dokumentet për rinovimin e autorizimeve paraqiten 30 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

Në rastet e rinovimit të autorizimit, kur në lëshimin e autorizimit përfshihen edhe palët kontraktuese, si vende destinacioni ose transiti për linjat e rregullta, dorëzimi i dokumentacionit bëhet 60–90 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

7.7 Sektori/ zyra/ specialisti përgjegjës, duhet:

a) për linjat ndërkombëtare me nisje/ origjinë nga Shqipëria, në rastet kur operon më shumë se një subjekt në të njëjtën linjë, të vendosë një kohë mbrojtëse nga njëra nisje në tjetrën. Në çdo rast kërkohet miratimi nga eprori përkatës;

b) të kërkojë çdo fillim viti informacion të detajuar nga organet e kontrollit në pikat e kalimit të kufirit, mbi operimin e subjekteve të pajisura me autorizime për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, ku të jepen të dhëna për respektimin e orareve, frekuencës, vendqëndrimeve dhe tarifave të miratuara në autorizimin përkatës, sipas anekseve bashkëlidhur autorizimit;

c) të krijojë një regjistrë elektronik, me qëllim hedhjen/ grumbullimin e të dhënave, për:

- subjektet e pajisura me licencë, autorizim për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve në linjë të rregullt;
- linjat e transportit ndërkombëtar dhe numrin e subjekteve për çdo linjë;
- mjetet, sipas subjekteve dhe linjave përkatëse,
- shkeljet e konstatuara nga organet e kontrollit vendas dhe të huaj ndaj subjekteve shqiptare, lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së tyre në përputhje me dispozitat e përcaktuara në autorizim, kohën e drejtimit dhe të pushimit të drejtuesit të mjetit etj.

7.8. Pas vënies në funksion të shërbimit, të gjithë subjektet e transportit rrugor, janë të detyruar të regjistrohen në regjistrin elektronik kombëtar të transportit rrugor (REK), në zbatim të udhëzimit nr. 328, datë 20.1.2017, “Mbi rregullat e hollësishme për listën e të dhënave që mbahen në regjistrin elektronik kombëtar të transportit rrugor, si dhe modalitetet e mbajtjes së tij”.

7.9 Autoriteti kompetent duhet:

a) të verifikojë plotësimin në vazhdimësi të kushteve të licencimit, autorizimit, certifikimit për çdo subjekt transportit të licencuar, autorizuar, certifikuar prej tij;

b) pas licencimit, certifikimit për llogari të vet, të gjithë të dhënat, t’i përcjellë brenda 7 ditëve pune, mbajtësit të regjistrit elektronik kombëtar, për subjektin dhe çdo ndryshim që mund të ndodhë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

7.10 Praktikrat arkivohen në bazë të veprimtarive përkatëse sipas rendit alfabetik të subjektit, duke mbajtur shënimet e plota, të arkivimit dhe dorëzimit të tyre. Dokumentacioni ruhet nga sektori/ zyra/ specialisti përgjegjës përkatës për një periudhë trevjeçare dhe më pas dorëzohet në arkivin qendror të autoritetit kompetent.

8. Formatet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave, nënshkrimi dhe data lëshimit.

8.1 Licencat, autorizimet dhe certifikatat sipas veprimtarive përkatëse të transportit lëshohen sipas formateve të miratuara nga ministri, mbështetur në modelet e rregullores (KE) 1073/2009 dhe rregullores së Komisionit (BE) 361/2014, përcaktuar edhe në këtë udhëzim, përkatësisht sipas lidhjeve 1, 2, 2.1, 2.2 dhe 3.

8.2 Autorizimet në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe shkresat përcjellëse drejtuar ministrive homologe, palë në marrëveshje në fushën e transportit ndërkombëtar rrugor, nënshkruhen nga zëvendësministri, që mbulon çështjet e transportit.

8.2.1 Anekset që shoqërojnë autorizimet, pika 10.1, shkronjat “e”, “f”, “g”, “h” dhe “i”,

nënshkruhen nga specialisti përgjegjës i autoritetit kompetent dhe shoqërohen me vulën përkatëse, sipas procedurave të zyrës protokollit.

8.3 Certifikatat për shërbimet e transportit për llogari të vet, nënshkruhen nga titullari/ personi i autorizuar i autoritetit kompetent.

8.4 Data e lëshimit të autorizimit, dhe/ose certifikatës është data e nënshkrimit të tyre.

8.5 Licencat, autorizimet, certifikatat janë objekt i pagesës në llogarinë e autoritetit kompetent që i lëshon ato, në bazë të tarifave të miratuara sipas VKM nr. 1035, datë 9.7.2008, “Për caktimin e tarifës së licencimit të subjekteve, nga MPPT&T, në fushën e punimeve të ndërtimit dhe transportit”, të ndryshuar me VKM-në nr. 1123, datë 13.11.2009.

KAPITULLI V

KËRKESAT QË DUHET TË PLOTËSOJNË SUBJEKTET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR

9. Dokumente që kërkohen për t'u pajisur me licencë në transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve për të tretë dhe me qira.

9.1 Licenca për ushtrim veprimtarie në transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus lëshohet për subjektet që plotësojnë kriteret e përcaktuar në këtë udhëzim, të reflektuara edhe në aneksin 1, të VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar.

9.2 Licenca është kusht paraprak për lëshimin e autorizimeve për shërbimet në linjë të rregullt dhe të rregullt të specializuar.

9.3 Licenca i jep të drejtën subjektit për të ushtruar veprimtari për shërbime të rastit në transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve me autobus, në pajtim me shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 10.5, më poshtë.

9.4 Subjekti i paraqet autoritetit kompetent kërkesën (lidhja 5), e cila duhet të përmbajë:

- llojin e veprimtarisë që kërkohet të kryhet,
- të dhëna për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën,
- adresën e plotë të zyrës/ selisë/ filialit për ushtrimin e veprimtarisë,
- regjistrimi në QKB ose ekstrakti i QKB-së, ku në objektin e veprimtarisë të përcaktohet aktiviteti transport ndërkombëtar rrugor i udhëtarëve me autobus,
- dokumenti që vërteton se subjekti zotëron, të paktën një mjet të përshtatshëm për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, (targën/ targat e mjetit/ mjeteve që do përdoren) të regjistruara në QKB, shoqëruar me NUIS dytësor (certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm),
- plotësimi i kriterit të reputacionit të mirë për subjektin (përfaqësuesin ligjor dhe/ ose pronarin/ pronarët), si dhe për drejtuesin e veprimtarisë, që provohet me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit,
- dokument që vërteton zotërimin e CKP-së, për personin që drejton veprimtarinë e transportit që do të licencohet,
- kontrata e punës, akt që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës lidhur ndërmjet përfaqësuesit ligjor të subjektit dhe drejtuesit të veprimtarisë, në rastet kur subjekti nuk plotëson kërkesën e kompetencës profesionale,
- dokument i qëndrueshmërisë financiare,
- dokumente që vërtetojnë përmbushjen e kërkesave ligjore në lidhje me standardet dhe sigurinë për mjetet, që janë:
 - aktvlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit të mjeteve në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve sipas aneksit nr. 2, të udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, të ndryshuar,
 - policë sigurimi se pronari/ përdoruesi i mjetit të transportit ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të ndryshuar, i cili në transportin e udhëtarëve përfshin:

- i. sigurimin e udhëtarëve nga aksidentet në transportin publik,
 - ii. sigurimin e përgjegjësive së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.
- certifikata e kryerjes së kontrollit teknik të detyrueshëm,
 - certifikata e kalibrimit të tahografit,
 - certifikatat e aftësisë profesionale (CAP), për çdo drejtues mjeti,
 - çdo dokument tjetër shoqërues i cili kërkohet sipas legjislacionit të posaçëm sektorial, me kusht që këto dokumente, janë publikuar në regjistrin informativ për kategorinë e licencës, sipas VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar,
 - çdo dokument që subjekti kërkues gjykon se është i dobishëm për shqyrtimin e kërkesës së tij.

10. Shërbimi i transportit ndërkombëtar rrugor në linjë të rregullt të udhëtarëve

Për të ushtruar veprimtarinë në shërbimin e transportit ndërkombëtar rrugor në linjë të rregullt të udhëtarëve, pas pajisjes me licencë për transport ndërkombëtar rrugor, subjekti aplikon pranë ministrisë përgjegjëse për transportin për t'u pajisur me autorizim për operimin në një linjë të rregullt të caktuar dhe/ ose në transportin e rregullt të specializuar. Të drejtën për t'u pajisur me autorizim e fitojnë vetëm subjektet me eksperiencë në transportin rrugor brenda vendit ose në transportin rrugor ndërkombëtar në shërbime të rastit, jo më pak se 3 (tre) vjet, e cila provohet nga eksperiencia e vetë subjektit ose e drejtuesit të veprimtarisë.

10.1 Autorizim për të operuar në një linjë të rregullt ndërkombëtare transporti me autobus.

Autorizimi lëshohet për linja të rregullta ndërkombëtare të miratuara nga autoritetet kompetente të palëve kontraktuese, bazuar në marrëveshjet dypalëshe për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve. Miratimi i linjës nënkupton miratimin e itinerarit sipas një rendi udhëtimi me pika nisëse, pika kufitare hyrëse/ dalje, vendqëndrime (stacione) dhe pika mbërritëse të paracaktuara.

Subjekti i bashkëngjit kërkesës (lidhja 5), përveç kërkesave të pikës 9.4, aplikimin për autorizim sipas lidhjes 6, shoqëruar me dokumentet si më poshtë:

- a) plan biznesi të detajuar ekonomik-financiar për vitet në vijim, (informacion në lidhje me vëllimin e shërbimit që aplikanti planifikon të kryejë);
- b) një kopje e njësuar e licencës së lëshuar nga QKB-ja për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve;
- c) licencën e agjencisë për transport ndërkombëtar të udhëtarëve, lëshuar nga bashkia ku fillon linja, apo regjistrimin me NUIS dytësor të aktivitetit të agjencisë. Nëse nuk disponon licencë, paraqet kontratën me një agjenci të licencuar;
- d) dokumentet provuese dhe shoqëruese që vërtetojnë se subjekti ka në pronësi ose me qiramarrje, sipas shkronjës E.3, me afat jo më pak se një vit, numrin e nevojshëm të mjeteve për transport ndërkombëtar të udhëtarëve që plotësojnë standardet teknike të kërkuara. Për çdo mjet të marrë me qira, krahas dokumenteve provuese (shkronja "k", më poshtë), aplikuesi paraqet NUIS dytësor;
- e) kontratën e partneritetit, ose kontratën me një agjenci të licencuar në shtetin tjetër, ose licencën për shërbimin agjenci sipas legjislacionit në fuqi të shtetit tjetër, në rastet kur kërkohet sipas marrëveshjeve dypalëshe, (në katër kopje, dy në gjuhën shqipe dhe dy në gjuhën e shtetit palë në marrëveshje, ose në gjuhën angleze, ku tekstet në të dy/tri gjuhët të jenë autentike);
- f) rendin e udhëtimit me distancat kilometrike për çdo segment rrugor sipas itinerarit të linjës, ditët e operimit (frekuencën ditore, javore) me oraret e nisjes dhe të mbërritjes, bazuar në kontratën e partneritetit;
- g) tabelën e kohës së drejtimit të mjetit për të lejuar verifikimin e pajtueshmërisë me legjislacionin në lidhje me kohën e punës dhe periudhën e pushimit;
- h) projekt-tarifat e biletave të udhëtimit dhe bagazheve, të shoqëruar me elementet e kostos së tarifës të propozuar, të cilat miratohen nga autoriteti kompetent;

i) hartën sipas itinerarit të linjës përkatëse, me një shkallë të përshtatshme ku të dallohen qartë pika e nisjes (vendi origjinës), vendkalimet kufitare, vendqëndrimet dhe pika e mbërritjes (vendi i destinacionit);

j) dokumentin vërtetues të njehsuar me origjinalin për objektin e shërbimit të parkingut (në pronësi ose me qira) të mjeteve, vetëm për rastet kur parashikohet në marrëveshjet dypalëshe;

k) listën e autobusëve që do përdoren në linjën/at e kërkuar/a. Autobusët që do paraqiten për aplikim, duhet të jenë të pajisur me:

- aktvlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit, të autobusëve në transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve sipas aneksit nr. 2, të udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, të ndryshuar;

- policë sigurimi se pronari/ përdoruesi i mjetit të transportit ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, të ndryshuar, i cili në transportin e udhëtarëve përfshin:

- i. sigurimin e udhëtarëve nga aksidentet në transportin publik;

- ii) sigurimin e përgjegjësive së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

- certifikata e kryerjes së kontrollit teknik të detyrueshëm;

- certifikata e kalibrimit të tahogرافit;

- certifikatat e aftësisë profesionale (CAP), për çdo drejtues mjeti.

Për rinovim të autorizimit subjekti paraqet dokumentet, sipas shkronjave “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, “k”, “l” dhe informacion mbi volumin e transportit të udhëtarëve deri në afatin e përfundimit të autorizimit të mëparshëm, si dhe dokumentin vërtetues nga zyra përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për shlyerjen e detyrimeve tatimore.

Për rastet e modifikimit të linjave të rregullta të transportit të udhëtarëve me autobus, (zgjatimit të linjave, ndryshimit të vendqëndrimeve, të ditëve apo orarit të operimit), lëshohet një autorizim tjetër, me të njëjtin numër rendor me fraksion, por me të njëjtën periudhë vlefshmërie, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 10.1, për rinovimin e autorizimit.

Çdo mjet që kryhen një shërbim, i cili është subjekt autorizimi, duhet të ketë në bordin e tij një autorizim origjinal ose kopje të njehsuar me origjinalin/ të certifikuar nga autoriteti që e ka lëshuar.

Numri i mjeteve në transportin e udhëtarëve në linja të rregullta përcaktohet nga sektori/ zyra/ specialisti përgjegjës, në bazë të frekuencës së udhëtimeve, distancës së udhëtimit duke u siguruar që subjekti të ketë mjete të mjaftueshme për vazhdimin e shërbimit pa ndërprerje.

10.2 Autorizim për shërbimet e rregullta të specializuara të transportit ndërkombëtar, sipas pikës 3.12, rregullohen me të njëjtat procedura dhe dokumente, si dhe ato të shërbimeve në linjë të rregullt.

10.3 Modifikimi i autorizimit, nënkupton ndryshimet e konditave nën të cilat kryhet shërbimi i rregullt, pra ndryshimi i rendit të udhëtimit, frekuencës së udhëtimit, tarifës së biletave apo edhe të ndryshimit të stacioneve të marrjes/zbritjes së udhëtarëve apo zgjatimi ose ndryshimi i vetë linjës, (kur bihet dakord nga të dyja palët kontraktuese).

Në rastet e ndryshimeve të konditave të operimit të konsideruara të vogla (si ndryshimi i tabelës së tarifave të biletave, shtimi apo zëvendësimi i autobusëve që operojnë në linjë), palët kontraktuese njoftojnë njëra - tjetrën për ndryshimin e bërë, gjë që nuk sjell ndryshime në titullin e autorizimit, pra nuk ka nevojë për miratimin e dy shteteve palë në marrëveshje.

10.4 Autorizimi për subjektet e huaja të transportit për të operuar në një linjë të rregullt ndërkombëtare transporti me autobus.

Për subjektet e huaja, palë në marrëveshje, me kërkesë të autoritetit kompetent të atij shteti dhe të kontratës së partneritetit me një subjekt vendas apo kontratës së shërbimit agjenci (kur lejohet me marrëveshje dypalëshe), autoriteti kompetent lëshon autorizimin, sipas modelit të përcaktuar (lidhja 2.1).

Autorizimi lëshohet edhe për subjektet e huaja që kërkojnë të kalojnë transit nëpërmjet territorit të Shqipërisë, në përputhje me marrëveshjet dypalëshe dhe me kërkesë të autoritetit

kompetent të atij shteti, sipas modelit të përcaktuar (lidhja 2.2).

Njëkohësisht autoriteti kompetent i lëshimit të autorizimeve në shërbimet në linjë të rregullt, të rregullt të specializuar, i kërkon autoritetit kompetent të shtetit tjetër, palë në marrëveshje, lëshimin e autorizimit për subjektin shqiptar për të operuar ose transituar në territorin e atij shteti.

Për t'u pajisur me autorizim për territoret e vendeve ku kalon transit ose ku përfundon linja, subjekti transportues paraqet *jo më pak se 90 ditë kalendarike* përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së autorizimit ekzistues, kërkesën së bashku me katër kopjet e dokumenteve sipas shkronjave “e”, “P”, “g”, “h”, “i”, “j”, “k”, “l”, të pikës 10.1.

10.5 Libër udhëtimi/ autorizim për shërbim transporti ndërkombëtar të rastit me autobus.

Veprimtaria e shërbimeve ndërkombëtare të rastit me autobus kryhet vetëm nga subjektet e licencuara për transport ndërkombëtar rrugor udhëtarësh.

Transporti ndërkombëtar i rastit i udhëtarëve me autobus, realizohet në përputhje me marrëveshjen INTERBUS, e cila nuk përfshin operimet e transportit për llogari të vet.

Autobusët e përdorur për të kryer shërbime ndërkombëtare të rastit sipas kësaj marrëveshje duhet të jenë në përputhje me standardet teknike të paraqitura në anekset e saj.

Marrëveshja INTERBUS përfshin dy lloj shërbimesh:

a) *Shërbimet e rastit të liberalizuara*, të cilat realizohen nëpërmjet librit të udhëtimit:

Libri i udhëtimit lëshohet nga Autoriteti kompetent, i autorizuar nga ministri, pasi subjekti paraqet:

- kërkesën për t'u pajisur me librin e udhëtimit,
- licencën për transport ndërkombëtar udhëtarësh.

Libri i udhëtimit, përdoret për 25 udhëtime të shërbimeve të rastit. Për marrjen e librit të udhëtimit pasardhës, subjekti dorëzon librin paraardhës me kopjet e fletëve të përdorura.

b) *Shërbimet e rastit të paliberalizuara* realizohen me autorizim të lëshuar nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese.

Për marrjen e autorizimit, subjekti i huaj, i cili nuk është vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë paraqet:

- formularin e aplikimit sipas Marrëveshjes INTERBUS;
- licencën e lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit ku është vendosur subjekti.

c) *Shërbimet e rastit* me shtetet, të cilët nuk janë anëtare të Marrëveshjes INTERBUS, realizohen në përputhje me marrëveshjet dypalëshe, në bazë të librit të udhëtimit (dokumentit të kontrollit, lidhja 4).

Libri i udhëtimit lëshohet nga autoriteti kompetent, i autorizuar nga ministri, pasi subjekti paraqet:

- kërkesën për t'u pajisur me librin e udhëtimit,
- licencën për transport ndërkombëtar udhëtarësh.

Subjekti plotëson dokumentin e kontrollit (fleta e udhëtimit të librit të udhëtimit), përpara fillimit të çdo udhëtimi dhe e mban atë në bordin e mjetit përgjatë gjithë udhëtimit.

11. Dokumentacioni i nevojshëm për certifikim për operimet e transportit për llogari të vet.

11.1.Për kryerjen e shërbimit për llogari të vet, kur përcaktohet në marrëveshjet dypalëshe, subjekti i paraqet autoritetit kompetent:

- kërkesën për kryerjen e këtij shërbimi (lidhja 5) dhe formularin e vetëdeklarimit (lidhja 7);
- datat e hyrje-daljes, itinerarin e udhëtimit, vendqëndrimet dhe pikat e kalimit kufitar;
- emrin/ mbiemrin e drejtuesit të grupit dhe dokumentet e mjetit;
- informacion ku dëshmohet se janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nënpikën 3.16. të këtij udhëzimi;

- aktin e pronësisë mbi mjetin ose kontratën e qiramarrjes në emër të subjektit.

Mjetet që do paraqiten për aplikim, duhet të jenë të pajisur me:

- aktvlerësimin në plotësimin e kushteve të komoditetit, të mjeteve në transportin

ndërkombëtar të udhëtarëve sipas aneksit nr. 2, të udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, të ndryshuar,

- policë sigurimi se pronari/ përdoruesi i mjetit të transportit ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, të ndryshuar, i cili në transportin e udhëtarëve përfshin:
 - i. sigurimin e udhëtarëve nga aksidentet në transportin publik,
 - ii. sigurimin e përgjegjësive së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.
- certifikatën e kryerjes së kontrollit teknik të detyrueshëm,
- certifikatën e kalibrimit të tahogرافit.
- certifikatat e aftësisë profesionale (CAP), për çdo drejtues mjeti.

11.2 Subjekti që kërkon pajisjen me certifikatë/a sigurohet që, çdo mjet i cili kryen një shërbim, duhet të mbajë në bordin e mjetit gjatë gjithë udhëtimit një certifikatë ose kopjen e saj të certifikuar/ noterizuar/ njehsuar me origjinalin, e cila do t'i paraqitet organeve të kontrollit të autorizuar për inspektim, me kërkesën e tyre.

12. Lëshimi, pezullimi dhe heqja e licencës, autorizimit, certifikatës

12.1 Lëshimi i licencës, autorizimit, certifikatës.

Licenca lëshohet kur aplikanti plotëson kushtet e kapitullit III, pika 6, shkronjat A, B, C dhe D (një vendosjeje efektive dhe të qëndrueshme në Shqipëri, reputacioni i mirë, qëndrueshmëria financiare, kompetenca profesionale), si dhe kërkesat në lidhje me mjetet, shkronja E (gjendja e përshtatshme e mjeteve).

Licenca, autorizimi nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj te një subjekt tjetër.

Titullari i licencës/ autorizimit për kryerjen e veprimtarisë për të cilën është licencuar ose autorizuar, mund të lidhë marrëdhënie nënkontraktuale me një subjekt të tretë. Titullari i licencës/ autorizimit është përgjegjës për plotësimin e kushteve të licencimit/ autorizimit edhe për pjesën e veprimtarisë që kryhet nga nënkontraktori.

Nënkontraktori duhet të kënaqë kërkesat e parashtruara në pikën 6 të udhëzimit.

12.1.1 Licenca, autorizimi, certifikata lëshohet/ jepet, përveç rasteve kur:

- a) aplikanti është i paafte të sigurojë shërbimin me pajisjet të disponueshme për atë shërbim;
- b) aplikanti nuk ka plotësuar kërkesat në lidhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar mbi transportin rrugor dhe në veçanti kushtet dhe kërkesat lidhur me autorizimet për shërbimet e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve, ose ka kryer shkelje serioze të legjislacionit të transportit rrugor lidhur me rregullat e aplikueshme për kohën e drejtimit dhe periudhave të pushimit të drejtuesve të mjeteve;
- c) për rinovimin e autorizimit, kushtet e autorizimit nuk janë plotësuar;
- d) autoriteti kompetent, mbi bazën e analizave të detajuara, është i bindur që qëllimi kryesor i shërbimit nuk është transporti i udhëtarëve ndërmjet stacioneve të vendosura në territorin shqiptar dhe/ ose në territorin e një shteti tjetër.

Fakti që, subjekti ofron tarifa më të ulëta se ato të ofruara nga subjektet e tjera, ose fakti që linja në fjalë tashmë është duke u operuar nga një subjekt rrugor tjetër, nuk përbën në vetvete justifikim për refuzimin e aplikimit.

Autoriteti kompetent mund të refuzojë aplikimin vetëm mbi bazën e arsyeve të dhëna në këtë udhëzim.

12.2 Pezullimi dhe heqja e licencës, autorizimit, certifikatës.

Parimet për përcaktimin e shkaqeve dhe të procedurave, për revokimin e licencës, autorizimit, certifikatës.

Në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, të ndryshuar dhe në zbatim të nenit 12, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, të ndryshuar, autoriteti kompetent merr masa për pezullimin ose heqjen (revokimin) e licencës, autorizimit, certifikatës nëse titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij dokumenti apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.

Konstatimi i mosplotësisë së kriterëve apo shkeljes së detyrimeve, bëhet, si rregull, nga organet kompetente të inspektimit.

Përpara marrjes së vendimit të revokimit, organi kompetent, si rregull, urdhëron ripërbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda një afati të arsyeshëm, pa pezullim dhe/ ose me pezullim të dokumentit (aktit administrativ), për një afat të arsyeshëm, deri në zbatimin e urdhrit për ripërbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve.

Urdhri i pezullimit revokohet nga organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, kur vlerësohet se subjekti i ka plotësuar të gjitha detyrimet, sipas rastit.

Licenca, autorizimi, certifikata, si rregull, revokohen:

a) kur rrethanat janë të tilla, që s'do të kishte kuptim apo mundësi për ripërbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga titullari, brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi;

b) në rast të moszbatimit të urdhrave, brenda afateve të arsyeshme të pezullimit;

c) në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga subjekti dhe/ ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtim të interesit publik, që garantohet nga titulli (akti administrativ), përkatës apo legjislacioni në fuqi;

d) nuk zbaton legjislacionin në fuqi, për personat me aftësi të kufizuara, të konstatuara nga organet e kontrollit.

Kur autoriteti kompetent vërteton që një subjekt i licencuar prej tij rrezikon plotësimin e kërkesave të pikës 6, të këtij udhëzimi, ai duhet të njoftojë zyrtarisht personin përgjegjës ose drejtuesin e veprimtarisë së subjektit për këtë. Nëse autoriteti kompetent vëren se një ose më shumë prej kërkesave nuk plotësohet në vazhdimësi, me qëllim rregullimin e situatës, ai i jep subjektit mundësi të kufizuara kohore, si vijon:

a) një periudhë kohore 6–9 muaj për marrjen në punë të një drejtuesi zëvendësues veprimtarie, në rastin kur mbajtësi i licencës nuk përmbush kërkesën e kompetencës profesionale dhe ka lidhur kontratë me një drejtues veprimtarie, i cili:

i. ndërron jetë,

ii. ndërpret veprimtarinë për arsye të paaftësisë fizike ose mendore,

iii. ndërpret veprimtarinë për arsye të tjera,

iv. nuk plotëson kërkesën e reputacionit të mirë,

v. nuk plotëson më kërkesën e kompetencës profesionale.

b) në rastin kur mbajtësi i licencës ka të punësuar dy ose më shumë drejtues veprimtarie, dhe ndonjëri prej këtyre drejtuesve humbet reputacionin e mirë, autoriteti kompetent i kërkon mbajtësit të licencës zëvendësimin e drejtuesit të veprimtarisë;

c) një periudhë kohore 6–12 muaj, kur kriteri i qëndrueshmërisë financiare nuk plotësohet, me qëllim që kjo kërkesë do të plotësohet përsëri në baza të qëndrueshme.

Licenca, autorizimi dhe certifikata hiqen kur mbajtësi i tyre, provohet se:

a) ka paraqitur deklaratime të pavërteta, informacion jo të saktë dhe/ ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat që kërkohen për lëshimin e licencës, autorizimit, certifikatës;

b) nuk fillon veprimtarinë brenda afatit prej 3 muaj nga dita e lëshimit të licencës dhe autorizimit;

c) kryen shkelje të rënda e të përsëritura në lidhje me kushtet e përshkuara në licencë, autorizim në lidhje me itinerarin, vendqëndrimet, frekuencën dhe oraret, specifikisht për shërbimin në linjë të rregullt;

d) ka kryer shkelje serioze në përmbushjen e kushteve të shkronjës B.4, të këtij udhëzimi;

e) nuk zbaton legjislacionin në fuqi në mënyrë të përsëritur, të konstatuara nga organet e kontrollit, për personat me aftësi të kufizuara.

12.3.Procedurat për pezullimin ose heqjen e licencës, autorizimit, certifikatës.

Autoriteti kompetent kur vendos për pezullimin ose heqjen e një licence, autorizimi, certifikate:

a) njofton mbajtësin e dokumentit përkatës për vendimin dhe arsyet, për të cilat ai ka marrë këtë vendim;

b) pezullimi ose heqja e licencës, autorizimit dhe certifikatës hyn në fuqi në fund të periudhës

20 ditë pune, duke filluar me ditën, që njoftimi i është dhënë mbajtësit të dokumentit përkatës.

Mbajtësi i një licence, autorizimi, certifikate mund të ankimojë vendimin për pezullimin ose heqjen e dokumentit përkatës. Ankimimi i drejtohet titullarit të autoritetit kompetent brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit për vendimin e pezullimit ose heqjes.

Në rast se subjekti, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e lëshimit, nuk tërheq licencën, autorizimin, certifikatën dhe nuk paraqet provën e pagesës, autoriteti kompetent i vlerëson automatikisht të revokuara, bazuar në nenin 24, të ligjit nr. 10081/2009, datë 23.2.2009, të ndryshuar.

Licenca, autorizimi, certifikata anulohet edhe me kërkesë të vetë subjektit. Në transportin e udhëtarëve në shërbimet e rregullta, autoriteti kompetent që ka lëshuar autorizimin njoftohet të paktën dy muaj përpara ndërprerjes së veprimtarisë. Në kërkesën për anulimin e autorizimit duhet të përcaktohet data e ndërprerjes së shërbimit dhe arsyet e kësaj ndërprerje.

13. Vendimet e autoritetit kompetent

13.1 Autoriteti kompetent, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse në fuqi, merr vendime që përfshijnë refuzimin e një aplikimi, pezullimin ose heqjen e licencës, autorizimit dhe deklarimin e papërshtatshëm të drejtuesit të veprimtarisë. Çdo vendim i marrë, shoqërohet me arsyetimin mbi shkaqet e refuzimit të aplikimit, pezullimit dhe heqjes së licencës, autorizimit, certifikatës.

13.2 Autoriteti kompetent refuzon kërkesën për licencim/ autorizim, kur drejtuesi i veprimtarisë dënohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, në përputhje me shkronjën “a” dhe “b”, të pikës 3.1, të kapitullit II, të VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar, ose kur nuk ka plotësuar periudhën e rehabilitimit nga data, që i është komunikuar dënimi.

13.3 Para marrjes së një vendimi sipas pikës 13.2. më lart, për shkeljet e kryera nga subjekti ose drejtuesi i veprimtarisë, autoriteti kompetent, përveç organeve të kontrollit në rrugë sipas ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, të ndryshuar, nëse është e nevojshme, grumbullon informacione që konsiderohen të rëndësishëm në veprimtarinë e transportit rrugor edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave apo institucione të tjera.

13.4 Penalitetet

a) shkeljet e dispozitave të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, të ndryshuar kur nuk janë objekt i veprave penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë e me masa plotësuese të pezullimit të licencës, autorizimit ose të certifikatës dhe të lejes së qarkullimit;

b) mbajtësi i licencës/autorizimit pas pagesës së çdo udhëtari që përdor këtë shërbim, është i detyruar të pajisë atë me biletë ose faturë si provë e ekzistencës së një kontrate mes tyre. Mosrespektimi i kësaj dispozite dënohet me masë administrative sipas neneve 10 dhe 68 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, të ndryshuar;

c) cilido që shfrytëzon dhe përdor një mjet, për:

i. përdorim vetjak për transportin e njerëzve, me përjashtim të autoveturave për përdorim vetjak të përcaktuara në lejen e qarkullimit, pa licencën, autorizimin, certifikatën përkatëse ose nuk respekton kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në lejen e qarkullimit, ndëshkohet me masë administrative sipas pikave 4 dhe 5, të nenit 82, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, të ndryshuar;

ii. qiradhënie me drejtues mjete, që nuk është caktuar për një shërbim në linjat për të cilat është regjistruar si i tillë, ndëshkohet me masë administrative sipas pikës 4, të nenit 84, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, të ndryshuar;

iii. shërbimin në linjë, i cili nuk është caktuar për një shërbim të tillë apo përdor një mjet në linja të ndryshme me ato, për të cilat është autorizuar, ndëshkohet me masë administrative sipas pikës 6, të nenit 86, ligjit nr. 8378, të ndryshuar;

iv. i cili nuk është autorizuar për shërbime të rregullta të specializuara, apo i certifikuar për operimet e transportit për llogari të vet, ose nuk operon në përputhje me dispozitat e përgjithshme për këto lloj shërbimesh, ndëshkohet me masë administrative sipas shkronjës “a”, të

nenit 68, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, të ndryshuar.

13.5 Ankimimi

Në rastin kur, autoriteti kompetent refuzon një kërkesë për pranimin në veprimtarinë e transportit rrugor, pezullon ose deklaron të papërshtatshëm për shkeljet e kryera nga subjekti ose drejtuesi i veprimtarisë, personi i refuzuar, pezulluar ka të drejtë të ankimojë vendimin e marrë, në bazë të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe për procedura të mëtejshme, ai mund të ankohet në rrugë gjyqësore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

13.6 Dorëzimi i licencës, autorizimit, certifikatës

Pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë, licenca, autorizimi, certifikata dorëzohen pranë autoritetit kompetent, i cili i ka lëshuar. Në rastet e heqjes së licencës, autorizimit, certifikatës, brenda 10 ditë pune, dokumentet e mësipërme dorëzohen pranë autoritetit kompetent.

Për pezullimin e një licence, autorizimi, certifikate, autoriteti kompetent njofton me shkrim mbajtësin e licencës, autorizimit, certifikatës, që të dorëzojë këto dokumente brenda 10 ditë pune, nga marrja e njoftimit.

Nëse, një subjekt nuk dorëzon pranë autoritetit kompetent, brenda afatit të përmendur në paragrafët e mësipërm, dokumentin e pezulluar ose të hequr, ky i fundit njofton organet përgjegjëse të kontrollit në rrugë, pikat e kalimit kufitar dhe të gjitha organet e tjera të interesuara e për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit.

13.7 Pavlefshmëria dhe zëvendësimi i licencës, autorizimit, certifikatës

Zëvendësimi i licencës, autorizimit, certifikatës bëhet me kërkesë të vetë titullarit të dokumentit, për rastet kur kërkohet ndryshim i ndonjë elementi përbërës të tij, ose deklarohet e humbur, e vjedhur, e shkatërruar apo kur është dëmtuar (janë bërë të palexueshme specififikimet në të):

a) nëse dokumenti ka humbur ose është vjedhur, subjekti informon menjëherë, brenda 7 ditë pune, me shkrim autoritetin e licencimit, autorizimit, certifikimit. Nëse dokumenti i humbur gjendet, subjekti e dorëzon atë tek autoriteti kompetent;

b) kur dokumenti bëhet i palexueshëm ose dëmtohet, ai duhet të dorëzohet tek autoriteti kompetent i lëshimit të dokumentit përkatës.

Autoriteti kompetent brenda një afati 10 ditë pune, ka detyrimin të lëshojë një dokument zëvendësues me të njëjtin afat vlefshmërie, kundrejt pagesës.

14. Periudha e vlefshmërisë dhe modelet e licencës, autorizimit, certifikatës

Licenca për transport ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve për të tretë dhe me qira lëshohet nga QKB-ja, sipas VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar, dhe është me vlefshmëri deri në 10 vjet, (në përputhje me licencën komunitare të përcaktuar në rregulloren 1073/2009). Modeli i licencës është sipas lidhjes 1, me elementë sigurie sipas lidhjes 1.1.

Autorizimi për transport ndërkombëtar të udhëtarëve në linjë të rregullt, si për subjektet vendase ashtu edhe për subjektet e huaja, lëshohet nga ministria përgjegjëse për transportin, sipas këtij udhëzimi, dhe ka një vlefshmëri deri në 5 vjet, (në përputhje me rregulloren 1073/2009 dhe marrëveshjet bilaterale). Modelet e autorizimeve janë përkatësisht sipas lidhjes 2, lidhjes 2.1 dhe lidhjes 2.2.

Certifikata e transportit ndërkombëtar për llogari të vet, lëshohet me vlefshmëri deri në 5 vjet, sipas kërkesës së subjekteve (në përputhje me rregulloren (BE) nr. 361/2014). Modeli i certifikatës është sipas lidhjes 3.

Autorizim i përkohshëm 1–3-mujor për vazhdimin e veprimtarisë, jepet nga autoriteti kompetent që i ka lëshuar ato, për rastet e rinovimit të autorizimit, kur vonesat në rinovim, që nuk janë përgjegjësi e aplikantit, rrezikojnë ndërprerjen e veprimtarisë. Ky autorizim lëshohet jo më shumë se 2 (dy) herë.

Licenca e transportit (kopje e certifikuar)/ autorizimi (kopje e certifikuar), certifikata për

llogari të vet, libri i udhëtimit, lista e udhëtarëve/ dokumenti i udhëtimit, në origjinal, mbahen në bordin e mjetit. Ato janë objekt kontrolli dhe iu paraqiten autoriteteve të kontrollit sa herë që kërkohen.

KAPITULLI VI

15. Dispozita transitore dhe të fundit

15.1 Licencat për transport ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve të VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar, lidhur me afatin dhe modelin e licencës, do vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je.

15.2 Autorizimet e transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve për shërbimet në linjë të rregullt dhe certifikatat e transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve për llogari të vet, të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të vazhdojnë të jenë në fuqi deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë.

15.3 Lidhjet bashkëlidhur këtij udhëzimi janë pjesë përbërëse e tij.

15.4 Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, dispozitat përkatëse të udhëzimit nr. 15, datë 24.7.2007, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar, të cilat lidhen me transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve, shfuqizohen.

15.5 Pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, modeli i licencës nr. 107 dhe modelet e autorizimeve nr. 301, nr. 302, nr. 304 dhe nr. 305, të udhëzimit nr. 20, datë 10.10.2007, “Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.


MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

Modeli Licencës

[Sipas Rregullores (KE) nr. 1073/2009]

(Letër format A4 celulozë, 100 – 120 g/m², ngjyra Pantone blu e lehtë)

(Faqja e parë e licencës)

	Autoriteti Kompetent <i>Competent Authority</i>
<p>LICENCË Nr. <i>LICENCE No.</i> (Ose / or)</p> <p>KOPJE E CERTIFIKUAR Nr. <i>CERTIFIED TRUE COPY no.</i></p>	
<p>Për transport ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus për të tretë ose me qira <i>(For the international carriage of passengers by coach and bus for hire or reward)</i></p>	
<p>Mbajtësi i kësaj licence ⁽¹⁾ <i>(The holder of this licence)</i></p>	
<p>është i autorizuar të kryejë transport ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus për të tretë ose me qira brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në pajtim me kushtet e përcaktuara në Rregulloren (KE) nr. 1073/2009, mbi rregullat e përbashkëta për hyrjen në tregun ndërkombëtar të shërbimeve me autobus dhe në përputhje me dispozitat e përgjithshme të kësaj licence. <i>(Is authorised to carry out international carriage of passengers by coach and bus for hire or reward in and out of the Albanian territory, pursuant to the conditions laid down by Regulation (EC) no 1073/2009 on common rules for access to the international market for coach and bus service and in accordance with the general provisions of this licence)</i></p>	
<p>Komente: <i>(Comments):</i></p>	
<p>Licenca është e vlefshme nga: <i>(Licence is valid from):</i></p>	<p>deri më: <i>(To):</i></p>
<p>Lëshuar në: <i>(Issued in):</i></p>	<p>më datë: <i>(On):</i></p>
<p>..... Nënshkrimi dhe vula e autoritetit kompetent <i>(Signature and stamp of the competent authority)</i></p>	

⁽¹⁾ Emri i plotë ose emri tregtar dhe adresa e plotë e subjektit,
(Full name or trade name and full address of the carrier)

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Licenca lëshohet në përputhje me rregulloren (KE) nr. 1073/2009.
(This licence is issued pursuant to Regulation (EC) No 1073/2009.)
 2. Licenca lëshohet nga autoriteti kompetent i vendit të themelimit të subjektit në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus për të tretë ose me qira, i cili:
 - a) është i autorizuar në vendin e themelimit të kryejë shërbimet në linjë të rregullt, përfshirë shërbimet në linjë të rregullt të specializuar, ose shërbimet e rastit me autobus;
 - b) kënaq kushtet e përcaktuara në përputhje me rregullat e pranimit në profesionin e operatorit të transportit në operimet e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar;
 - c) përbush kërkesat ligjore në lidhje me standardet për drejtuesit e mjeteve dhe mjetet.*(This licence is issued by the competent authority of the Country of establishment of the carrier for hire or reward who:*
 - a) *is authorised in the Country of establishment to undertake carriage by means of regular services, including special regular services, or occasional services by coach and bus;*
 - b) *satisfies the conditions laid down in accordance with rules on admission to the occupation of road passenger transport operator in national and international transport operations;*
 - c) *meets legal requirements regarding the standards for drivers and vehicles.)*
 3. Licenca lejon transportin ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus për të tretë ose me qira në të gjitha hallkat e transportit për udhëtimet që kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, të Palëve Kontraktuese ose vendeve të treta.
 - a) pika e nisjes dhe pika e mbërritjes e të cilit janë në dy Palë të ndryshme Kontraktuese, me ose pa transit nëpërmjet një ose më shumë Palëve Kontraktuese ose vendeve të treta;
 - b) pika e nisjes dhe pika e mbërritjes janë në të njëjtën Palë Kontraktuese, ndërsa marrja ose zbritja e udhëtarëve është në një Palë tjetër Kontraktuese ose në një vend të tretë;
 - c) nga një Palë Kontraktuese drejt një vendi të tretë ose anasjelltas, me ose pa transit nëpërmjet një ose më shumë Palë Kontraktuese ose vende të treta; ose
 - d) ndërmjet vendeve të treta, me transit nëpër territorin e një ose më shumë Palëve Kontraktuese;dhe udhëtimet bosh në lidhje me operimet e transportit nën kushtet e përcaktuara me Rregulloren (KE) nr. 1073/2009.
(This licence permits the international carriage of passengers by coach and bus for hire or reward on all transport links for journeys carried out in the territories of Republic of Albania, Contracting Parties or third countries:
 - a) *where the point of departure and point of arrival are situated in two different Contracting Parties, with or without transit through one or more Contracting Parties or third countries;*
 - b) *where the point of departure and the point of arrival are in the same Contracting Party, while the picking up or setting down of passengers is in another Contracting Party or in a third country;*
 - c) *from a Contracting Party to a third country and vice versa, with or without transit through one or more Contracting Parties or third countries;*
 - d) *between third countries crossing the territory of one or more Contracting Parties in transit;**and empty journeys in connection with transport operations under the conditions laid down by Regulation (EC) No 1073/2009.)*
- Në rastin e një operacioni transporti nga territori shqiptar për në territorin e një Pale Kontraktuese ose vend të tretë dhe anasjelltas, Rregullorja (KE) nr. 1073/2009 është e zbatueshme, për pjesën e udhëtimit të përshkruar tranzit në territorin e Palës Kontraktuese, nëse kjo Palë Kontraktuese është shtet anëtar i BE-së. Ajo nuk zbatohet për atë pjesë të udhëtimit brenda territorit shqiptar për marrjen ose zbritjen e udhëtarëve (kabotazhi), përderisa një marrëveshje e nevojshme ndërmjet Shqipërisë dhe një Pale Kontraktuese ose vendi të tretë, nuk është përfunduar.
(In the case of a transport operation from Albanian territory to a territory of a Contracting Party or a third country and vice versa, Regulation (EC) No 1073/2009 is applicable, for the part of the journey on the territory of Contracting Party crossed in transit, if this Contracting Party is a Member State of EU. It does not apply to that part of the journey within the territory of the Albania of picking up or setting down, (Cabotage) as long as the necessary agreement between Albania and a Contracting Party or third country, has not been concluded.)
4. Licenca është personale dhe jo e transferueshme.
(This licence is personal and non-transferable.)
 5. Licenca mund të revokohet nga autoriteti kompetent në rastet kur subjekti:
 - a) nuk kënaq kushtet e përcaktuara në pikën 12.1 të udhëzimit nr. 8, datë 19.12.2019;
 - b) ka paraqitur deklarime të pavërteta, informacion jo të saktë dhe/ ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat që kërkohen për lëshimin ose rinovimin e licencës;
 - c) ka kryer një shkelje të rëndë ose shkelje të legjislacionit të transportit rrugor, veçanërisht në lidhje me rregullat e aplikueshme për automjetet, periudhat e drejtimit dhe pushimit për drejtuesit e mjeteve dhe kryerjen pa autorizim, të shërbimeve të rregullta ose të rregullta të specializuara. Autoriteti kompetent, mund, ndërmjet masave të tjera, të revokojë licencën ose të bëjë pezullim të përkohshëm të licencës.Këto ndëshkime përcaktohen në përputhje me seriozitetin e shkeljes së kryer nga mbajtësi i licencës, në lidhje me shërbimet në transportin ndërkombëtar.
(This licence may be withdrawn by the competent authority in particular where the carrier:
 - a) *no longer satisfies the conditions laid down in point 12.1 of instruction no 8, dated 19.12.2019;*

- b) has supplied inaccurate information regarding the data required for the issue or renewal of the licence;
- c) has committed a serious infringement or infringements of road transport legislation in any Contracting Parties, in particular with regard to the rules applicable to vehicles, driving and rest periods for drivers and the provision, without authorisation, of regular or special regular services. The competent authority may, inter alia, withdraw the licence or make temporary withdrawals of the licence.

These penalties are determined in accordance with the seriousness of the breach committed by the holder of the licence in respect of his international transport services.)

6. Licenca origjinale duhet të mbahet nga subjekti. Një kopje e certifikuar e licencës duhet të mbahet në mjetin që kryen një operim transporti ndërkombëtar.

(The original of the licence must be kept by the carrier. A certified true copy of the licence must be carried on the vehicle carrying out an international transport operation.)

7. Licenca duhet të paraqitet me kërkesë të çdo zyrtari të autorizuar inspektues.

(This licence must be presented at the request of any authorised inspecting officer.)

8. Mbajtësi i licencës duhet, në territorin e çdo Pale Kontraktuese, të respektojë ligjet, rregulloret dhe masat administrative në fuqi në atë shtet, veçanërisht në lidhje me transportin dhe trafikun.

(The holder must, on the territory of each Contracting Party, comply with the laws, regulations and administrative measures in force in that State, particularly with regard to transport and traffic.)

9. “Shërbime të rregullta” nënkuptojnë shërbimet që sigurojnë transportin e udhëtarëve në intervale të caktuara përgjatë linjave të përcaktuara, në pikat e ndalimit të paracaktuara për marrjen dhe zbritjen e udhëtarëve dhe të cilat janë të hapura për të gjithë dhe sipas rastit, kur është e përshtatshme, me rezervim të detyrueshëm.

Natyra e shërbimit të rregullt nuk do të ndikohet nga ndonjë modifikim i kushteve të operimit të shërbimit.

Shërbimet e rregullta kërkojnë autorizim.

(“Regular services” means services which provide for the carriage of passengers at specified intervals along specified routes, passengers being taken up and set down at predetermined stopping points, and which are open to all, subject, where appropriate, to compulsory reservation.

The regular nature of the service shall not be affected by any adjustment to the service operating conditions. Regular services require authorisation.)

“Shërbimet e rregullta të specializuara” nënkuptojnë shërbimet e rregullta, nga kushdo që organizohen, të cilat sigurojnë transportin e kategorive të veçanta të udhëtarëve, me përjashtim të udhëtarëve të tjerë, në intervale të caktuara përgjatë linjave të përcaktuara, ku udhëtarët merren dhe zbriten në pika të ndalimit të paracaktuara.

Shërbimet e rregullta të specializuara përfshijnë:

- a) transporti i punonjësve shtëpi - punë dhe anasjelltas;
- b) transporti i nxënësve të shkollës dhe studentëve për dhe nga institucioni shkollor.

Fakti që, një shërbim i specializuar mund të ndryshojë në përputhje me nevojat e përdoruesve, nuk do të ndikojë në klasifikimin e tij si një shërbim i rregullt.

Shërbimet e rregullta të specializuara nuk kërkojnë autorizim, nëse këto shërbime kryhen nëpërmjet kontratave midis organizatorit dhe transportuesit/ subjektit.

Organizimi i shërbimeve paralele ose të përkohshme, që i shërbejnë të njëjtit publik si shërbimet ekzistuese të rregullta, kërkojnë autorizim.

(“Special regular services” means regular services, by whomsoever organised, which provide for the carriage of specified categories of passengers, to the exclusion of other passengers, at specified intervals along specified routes, passengers being taken up and set down at predetermined stopping points.

Special regular services shall include:

- a) the carriage of workers between home and work;
- b) carriage of school pupils and students to and from the educational institution.

The fact that a special service may be varied according to the needs of users shall not affect its classification as a regular service.

Special regular services do not require authorisation if they are covered by a contract between the organiser and the carrier.

The organisation of parallel or temporary services, serving the same public as existing regular services, requires authorisation.)

“Shërbime të rastit” nënkuptojnë shërbimet që nuk përfshihen në përkufizimin e shërbimeve të rregullta, duke përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara dhe karakteristika kryesore e të cilave është që ata transportojnë grupe të krijuara me iniciativën e një klienti ose të vetë transportuesit. Organizimi i shërbimeve paralele ose të përkohshme të krahasueshme me shërbimet ekzistuese të rregullta dhe që i shërbejnë të njëjtit publik, i nënshtrohen autorizimit në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 10.5, të udhëzimit. Këto shërbime nuk do të pushojnë së qeni shërbime të rastit vetëm për arsye se ato ofrohen në intervale të caktuara.

(“Occasional services” means services which do not fall within the definition of regular services, including special regular services, and whose main characteristic is that they carry groups constituted on the initiative of a customer or of the carrier himself. The organisation of parallel or temporary services comparable to existing regular services and serving the same public as the latter shall be subject to authorisation in accordance with the procedure laid down in point 10.5 of this instruction. These services shall not cease to be occasional services solely on the grounds that they are provided at certain intervals.)

Shërbimet e rastit nuk kërkojnë autorizim.


(Occasional services do not require authorisation.)

Karakteristikat e sigurisë së licencës


Licenca duhet të ketë të paktën dy nga karakteristikat e sigurisë si më poshtë:

- një hologram;
- flijet speciale në letër që bëhen të dukshme nën ndriçimin UV;
- të paktën një linjë mikroprinti (shtypja është e dukshme vetëm me një xham zmadhues e cila nuk riprodhohet nga makinat fotokopjuese);
- karaktere, simbole ose modele të prekshme;
- numërim i dyfishtë: numri serial dhe numri i lëshimit (të licencës);
- një sfond i sigurisë me motive të ndërthurura që shkëlqejnë (guilloche)* dhe të shtypur me ngjyrat e ylberit.

*



Faqja e parë e autorizimit
(Letër format DIN A4, 100 – 120 g/m², ngjyra rozë)

	Autoriteti Kompetent <i>Competent Authority</i>
---	--

AUTORIZIM Nr.
AUTHORISATION No.

Për një shërbim të rregullt ⁽¹⁾
For a regular service

Për një shërbim të rregullt të specializuar
For a special regular service

me autobus ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve palë në marrëveshje ndërkombëtare dypalëshe
By coach and bus between Albania and countries parties in bilateral international agreement

Për:

To:

(Emri, mbiemri ose emri tregtar i subjektit ose subjektit menaxhues, në rastin e një bashkimi të subjekteve)
(Name, surname or trade name of carrier or of managing carrier, in case of an association of undertakings)

Adresa:

Address:

Tel., Fax dhe/ose e-mail:

Telephone and fax number/ or e-mail:

Emri, adresa, nr. tel.& fax dhe/ose e-mail të bashkimit ose anëtarëve të subjekteve/ shoqërive/
ndërmarrjeve dhe nënkontraktorëve:
*Name, address, telephone and fax numbers/ or e-mail of associates or members of the carriers/ association/
undertakings and subcontractors:*

1.

2.

3.

Data e përfundimit të autorizimit:

